



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. (338)-00164 Regj. Them
Data e Regj: 03.02.2016

Nr.1061 (401) Vendimi
Data:21.09.2016

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e përbere nga:

SOKOL IBI - Gjyqtar

Asistuar prej sekretares Viola Palla, pasi shqyrtoi në seance gjyqesore publike, sot me date 21.09.2016, çeshtjen administrative me Nr.(338)-00164 Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

PADITES: “Ermelinda Dhimoshi” person fizik tegetar, e perfaqesuar ne gjykim me prokure te posaçme Nr.7255 Rep, Nr.4393 Kol, date 05.09.2016 nga Av:Shkelqim Shahollari me Nr.307 license, Dhoma e Avokatise Korce.

I PADITUR: 1. **Drejtoria e Apelimit Tatimor**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga juristja Mirela Veriga.
2. **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga.

OBJEKTI: Shfuqizimin e aktit administrativ njoftim vleresimi per detyrimet i dates 28.10.2015 lene ne fuqi me vendimin Nr.36112/1, date 11.01.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor qe ka lidhje me gjoben ne shumen 50.000 leke.

BAZA LIGJORE: Neni 32/a, 324, 328 i K.Pr.Civile, neni 109 I ligjit Nr.9920/2008 i ndryshuar.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, degjoi konkluzionet perfundimtare te pales paditese e cila perfundimisht kerkoi pranimin e padise, te pales se paditur e cila perfundimisht kerkoi rrezimin e padise,

VEREN

Se paditesi "Ermelinda Dhimoshi" eshte person fizik tregetar me adrese ne qytetin e Korces, sikurse rezulton nga ekstrakti i QKR-se.

Ne daten 18.09.2015 prane ambjenteve ku pala paditese ushtron aktivitetin e saj tregetar ne qytetin e Korces, paraqiten inspektoret e pales se paditur.

Inspektoret e pales se paditur kane ushtruar kontroll prane pales paditese ne baze te urdherit te punes te dates 07.09.2015 te Drejtorit te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Gjate kontrolit inspektoret e pales se paditur kane konstatuar se ne ambjentet e pales paditese u gjet duke punuar shtetesja Ermelinda Dhimoshi si dhe shtetesja Mira Zeka.

Ne perfundim te kontrolit eshte hartuar akti i konstatimit nga inspektoret e pales se paditur nje kopje te se cilit ia kane dhene perfaqesuesit te pales paditese e cila ka nenshkruar ne kete akt-konstatimi.

Me pas inspektoret e pales se paditur kane perpiluar procesverbalin e gjobes se dates 18.09.2015 ku kane vendosur denimin me gjobe te pales paditese ne masen e 50.000 leke per kryerjen e kundravajtes administrative te punesimit te shtetases Mira Zeka pa u deklaruar ne organin tatimor dhe te pasiguruar, fakt i cili parashikohet si kundravajte administrative ne nenin 119, pika 1, germa "a" te ligjit Nr.9920/2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.SH".

Pala paditese ka refuzuar te nenshkruaje marrjen dijeni per kete procesverbal te deminit me gjobe.

Me pas ne daten 21.09.2015 pala paditese e ka deklaruar si te punesuar ne organin tatimor shtetasen Mira Zeka, duke deklaruar se ka qene e punesuar qe nga data 10.09.2015.

Me aktin administrativ njoftim vleresimi per detyrimet tatimore date 28.10.2015 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe njoftohet pala paditese per detyrimin e saj per te paguar gjoben ne masen e 50.000 lekeve.

Pala paditese ka paraqitur kerkese ankimore ne Drejtorine e Apelimit Tatimor kunder njoftim vleresimit per detyrimet tatimore.

Me vendimin e dates 11.01.2016 te Drejtorise se Apelimit Tatimor eshte vendosur lenia ne fuqi e gjobes ne masen e 50.000 lekeve ndaj pales paditese.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi kesaj gjykate.

Ne kerkesepadi dhe gjate gjykimit pala paditese pretendon se nuk e ka kryer kundravajtjen administrative te parashikuar nga neni 119 i ligjit Nr.9920/2008, pasi e punesuar Mira Zeka ka qene e deklaruar ne organin tatimor qe ne daten 10.09.2015, sikurse rezulton nga deklarata e te punesuaresh rishtas dhe e te larguareve.

Ne rastin konkret pala paditese pretendon se kemi te bejme me nje vonese te pales se paditur per ta deklaruar ne sistem shtetasen Mira Zeka si te siguruar.

Pala e paditur ka prapesuar duke pretenduar se ne baze te deklarates se te punesuaresh rishtazi dhe te larguareve nga puna rezulton se kjo deklarate eshte plotesuar nga pala paditese ne daten 21.09.2015 dhe jo ne daten 10.09.2015 sikurse pretendon pala paditese.

Nga permbajtja e deklarates se te punesuaresh rishtazi dhe te larguareve nga puna rezulton se kjo deklarate eshte plotesuar nga pala paditese ne daten 21.09.2015 dhe jo ne daten 10.09.2015 sikurse pretendon pala paditese, nderkohe qe shtetesja Mira Zeka eshte punesuar nga pala paditese qe ne daten 10.09.2015.

Pra ne te tilla rrethana pala paditese e ka kryer kundravajtjen administrative te parashikuar nga neni 119/1, pika "a" te ligjit Nr.9920/2008, te punesimit pa deklaruar ne organin tatimor dhe te pasiguar te shtetases Mira Zeka. Ne te tilla

rrethana me te drejte pala e paditur e ka denuar me gjobe ne masen e 50.000 leke palen paditese.

Per keto arsye padia e paditesit eshte e pabazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille ajo duhet rrezuar nga gjykata.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"

VENDOSI

1. Rrezimin e padise si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.
 - Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
 - U shpall sot me date 21.09.2016 ne Korçe.

SEKRETARE

VIOLA PALLA

GJYQTAR

SOKOL IBI

Shpenzimet gjyqesore:

1. Takse pulle 3.000 leke;
Totali 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).